

VENDIM
Nr. 149, datë 30.9.2016

**MBI KËRKESAT E KESH SHA DHE MINISTRISË SË ENERGJISË DHE
INDUSTRIË PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 133, DATË 15.8.2016, TË BORDIT TË
ERE-s, “MBI MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË KESH SHA”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 16, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.9.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me kërkesat e KESH sh.a. dhe MEI-t për rishikim e vendimit nr. 133, datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a.”,

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a. ka marrë dijeni për vendimin e ERE-s nr. 133, datë 15.8.2016 nëpërmjet shkresës nr. 629 prot., datë 23.8.2016.

- MEI ka marrë dijeni për vendimin e ERE-s nr. 133, datë 15.8.2016 nëpërmjet shkresës nr. 629 prot., datë 23.8.2016.

- KESH sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën nr. 7375/1 prot., datë 1.9.2016 protokolluar me Tonën nr. 629/1, datë 14.9.2016, për rishikimin e vendimit nr. 133, datë 15.8.2016.

- MEI ka depozituar në ERE kërkesën nr. 5298/2 prot., datë 13.9.2016 protokolluar me tonën nr. 629/2, datë 14.9.2016, për rishikimin e vendimit nr. 133, datë 15.8.2016.

- Pika 5, e nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 16 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016”, parashikon se: “Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.”.

- Kërkesat e KESH sh.a. dhe MEI-t për rishikimin e vendimit nr. 133, datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s, janë depozituar jashtë afatit të parashikuar më sipër.

- Nga KESH dhe MEI nuk janë paraqitur prova të reja, të cilat të çojnë Bordin në marrjen e një vendim të ndryshëm nga ai nr. 133, datë 15.8.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e KESH sh.a., për rishikimin e vendimit nr. 133, datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a.” të paraqitur jashtë afateve.

2. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e MEI-t, për rishikimin e vendimit nr. 133 datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a.”, të paraqitur jashtë afateve.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a., Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti